REPUBLIKA E MAQEDONISË
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

UNIVERSITETI "NËNË TEREZA" në SHKUP
УНИВЕРЗИТЕТ „МАЈКА ТЕРЕЗА" - СКОПЈЕ

# B U L E T I N I

I

UNIVERSITETIT "NËNË TEREZA" në SHKUP

# Б И Л Т Е Н

НА

УНИВЕРЗИТЕТОТ „МАЈКА ТЕРЕЗА" - СКОПЈЕ

## Nr.18 / Бр.18

**Shkup, 10 dhjetor 2018**
**Скопје, 10 декември 2018**

**Botim i Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup**
**Издание на Универзитетот „Мајка Тереза“ - Скопје**

Redaktor i veprimtarisë botuese të UNT-së/ Уредник на издавачката дејност на УМТ:
Prof.dr.Azis Pollozhani, rektor

Redaktor i Buletinit / Уредник на Билтенот:
Prof.dr. Mustafa Ibrahimi

Këshilli redaktues i Buletinit / Уредувачки одбор на Билтенот:
Prof. dr. Rizvan Sulejmani
Prof. dr. Zoran Trifunov
Prof.dr. Mustafa Ibrahimi

**PËRMBAJTJA / СОДРЖИНА**

**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE / ФАКУЛТЕТ ЗА СОЦИЈАЛНИ НАУКИ**

Për zgjedhjen e një mësimdhënësit në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në fushën mësimore-shkencore: **Kineziologjisë aplikative** sipas klasifikimit të fushave shkencore-hulumtuese të fushave dhe nënfushave sipas Klasifikimit të Fraskatit në Fakultetin e Shkencave Sociale, të Universitetit "Nënë Tereza".

**(Dr.sc. Agon Saiti...........................................................................................................4-15)**

**R E F E R A T**

PËR ZGJEDHJEN E MËSIMDHËNËSIT NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE DOCENT NË FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE NË UNIVERSITETIN "NËNË TEREZA" NË SHKUP

Këshilli mësimor shkencor i Fakultetit të shkencave sociale pranë Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, në mbledhjen e mbajtur me datë 17.10.2018, solli Vendim me nr. 0202-79/1 të datës 17.10.2018 për formimin e komisionit recensues për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjen mësimore-shkencore docent në Fakultetin e Shkencave Sociale.

Komisioni recensues në përbërje:

1. Prof. inor.dr. Blerim Saiti, profesor inordinar - Fakulteti i Shkencave Sociale UNT,(Kryetar)
2. Prof. Dr. Fadil Nika, Fakulteti i Kulturës Fizike USHT, (Anëtar)
3. Prof. Dr. Jovan Jovanovski, Fakulteti i Kulturës Fizike, Sport dhe Shëndet UKIM (Anëtar),
   pas shqyrtimit të dokumentacionit të pranuar ka nderin që deri te Këshilli mësimorshkencor i Fakultetit të Shkencave Sociale pranë Universitetit "Nënë Tereza" Shkup,të paraqet këtë:

**R A P O R T**

Në konkursin e shpallur në gazetën "Koha" dhe "Nova Makedonija" më **05.10.2018** dhe ueb faqen www.unt.edu.mk/en/ të Universitetit "Nënë Tereza", për zgjedhjen e një mësimdhënësit në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit "Nënë Tereza" në lëmin e **Kineziologjisë aplikative** u paraqit vetëm një kandidat, **Dr.sc. Agon Saiti**.

## I.I TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Kandidati Dr.Sc Agon Saiti është lindur më 03.03.1976 në Shkup, Republika e Maqedonisë. Shkollimin fillor e kreu në vitin 1990, në Sh.F."Boris Kidriç" në Saraj me sukses të shkëlqyeshëm dhe me sjellje shembullore. Shkollën e mesme e kreu në gjimnazin "Zef Lush Marku" në Shkup, më vitin 1994, po ashtu me sukses të shkëlqyeshëm dhe me sjellje shembullore.

Në vitet 1995-99 studioi në në Fakultetin e Kulturës Fizike pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup. Diplomoi në vitin 1999, në temën "Njëra nga rrugët deri tek ping-pongisti kulmor", dhe fitoi thirrjen: profesor i edukimit fizik.

Në po të njëjtin fakultet, vazhdoi me studimet pasuniversitare, ku në vitin 2009, magjistroi në temën "**Relacionet e disa dimensioneve antropometrike dhe aftësive**

**biometrike tek ping-pongistët e Maqedonisë të cilët garojnë në Super ligë dhe Ligën e parë**” dhe morri titullin: magjistër i shkencave kineziologjike.

Në vitin 2008, në Universiteti Shën Kirili dhe Metodi - Fakulteti i Kulturës Fizike, Sport dhe Shëndet në Shkup, mbrojti disertacionin e doktoraturës me titull ”**Zhvillimi i aftësive motorike dhe karakteristikave psikologjike te nxënësit e adoleshencës së hershme gjinia mashkullore në moshën 13 dhe 14 vjeçare**”. Me këtë morri titullin doktor shkence në shkencat kineziologjike.

Kandidati Dr.Sc Agon Saiti spikatet edhe me të arritura të larta dhe të begatshme sportive. Që nga Janari i vitit 1986, ku si 10 vjeçar filloi të merret me sportin e ping-pongut, sukseset e tij nuk patën të ndalur. Në Karrierën e tij 25 vjeçare, në garat me karakter shtetëror si dhe ato regjional, ka fituar mbi 100 tituj, me çka llogaritet si njëri nga më të mirë në historinë e këtij sporti në Maqedoni. Me 13 titujt e fituar në garat individuale shtetërore për të rritur, Agonin e bën rekordist në këtë kategori në historinë e ping pongut në Maqedoni. Kandidati ka qenë edhe kampion i shumëfishtë shtetëror për te rritur në kategorinë e dysheve (mashkull-mashkull) dhe dysheve të kombinuar (mashkull-femër). Gjithashtu, kandidati me lojërat e tij të suksesshme, ka kontribuar që me ekipet e Student Termo Skopje nga Shkupi, Vardar nga Shkupi, Floraskop nga Shkupi si dhe ekipin e Jugokoktës nga Shtipi nga disa herë të shpallet kampion shtetëror në garat ekipore për të seniorë. Fitues i shumëfishtë edhe në garat të ashtuquajtura “Top 8“ dhe Top 12“ për senior.

Ka qenë fitues i një gare me karakter mbarëkombëtarë, ku kanë marrë pjesë të gjithë ping-pongistët më të mirë shqiptar nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia si dhe një lojtarë nga Suedia. Kampion shtetëror në garat individuale për juniorë dhe pionierë, kampion shtetëror ekiporë për pionierë dhe juniorë si dhe kampion shtetëror në dyshe dhe dyshe të përziera në konkurrencën e juniorëve dhe pionierëve. Ka qenë edhe pjesëmarrës në disa kampionate Botërore dhe Evropiane por pa ndonjë sukses të veçantë.

Kandidati pas përfundimit të karrierës sportive si lojtar aktiv, nga ana e Federatës së Ping-pongut të Maqedonisë, është i angazhuar si drejtor sportiv. Detyrat dhe qëllimet kryesore të kandidatit nga kjo pozitë janë: organizimin, kontrollin dhe koordinimin e seleksionuesve në të gjitha kategoritë. Së bashku me seleksionuesit, merr pjesë në përpilimin e programeve profesionale sportive, si në ato makro, ashtu edhe në ato mikro cikluse.

## I.II. PËRVOJA E PUNËS

- 2017/18 - U angazhua si bashkëpunëtor i jashtëm në Universitetin Nënë Tereza, në Fakultetin e shkencave sociale, programi studimor Sport dhe shkenca sportive, në lëndët Antropomotorika dhe Bazat e statistikës sportive.
- 2002/03 -Në Universitetin e Prishtinës-Fakulteti i Edukimit Fizike dhe i Sportit u angazhua si bashkëpunëtor i jashtëm, në rolin e profesorit nga lënda zgjedhore Ping-pong.
- 1999/2002 – U punësua si bashkëpunëtor i jashtëm në Universitetin e Tetovës, programin studimor: Kulturë Fizike në rolin e asistentit në lëndën: Psikomotorika 2.
- 2000/ on going. - Punon në marrëdhënie të rregullt pune në SH.M.Q.SH. ”Zef Lush Marku” si profesor në lëndën e Sportit dhe aktiviteteve sportive.
- 1999/2001. – Punoi në shkollën fillore ”Bajram Shabani” si arsimtar nga lënda e edukatës fizike.

## II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Gjatë vitit akademik 2002-03 në Fakultetin e Kulturës Fizike në Prishtinë kandidati ka mbajtur ligjërata në ciklin e parë të studimeve në lëndën e Ping-pongut.

Gjatë viteve akademike të periudhës 2017-2018 në Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin "Nënë Tereza" dhe në vitet akademike 1999-2002 në Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës, kandidati ka mbajtur ushtrime me studentët në këto lëndë:

1. Antropomotorikë, viti akademik 2017-18 (Fakulteti i Shkencave Sociale- UNT)
2. Bazat e Kineziologjisë viti akademik 2017-18 (Fakulteti i Shkencave Sociale- UNT)
3. Bazat e Statistikës në sport, viti akademik 2017-18 (Fakulteti i Shkencave Sociale- UNT)
4. Psikomotorika II, viti akademik 1999-2002 (Fakulteti i Kulturës Fizike UT)

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin "Nënë Tereza" Shkup, kandidati Dr. Sc. Agon Saiti ka realizuar gjithsej **13.06** pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

## III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin edukativo arsimor, kandidati është marrë vazhdimisht me realizimin e veprimtarisë hulumtuese shkencore në fushën e Kineziologjisë. Veprimtaria e tij shkencore hulumtuese përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare.

Kjo veprimtari e kandidatit është paraqitur si më poshtë:

1. **A. Saiti**, STRUCTURE OF ANTHROPOMETRIC DIMENSIONS OF TABLE TENNIS PLAYERS IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA WHO COMPETE IN THE SUPER LEAGUE AND FIRST LEAGUE,*3rd International Scientific Conference,Ss. Cyril andMethodius University in Skopje, Faculty of Physical Education, Sport, and Health,* 2018, pp.17-21

2. **A. Saiti**, STRUCTURE OF BIOMOTOR ABILITIES OF TABLE TENNIS PLAYERS INTHE REPUBLIC OF MACEDONIA WHO COMPETE IN THE SUPER LEAGUE AND FIRST LEAGUE,*3rd International Scientific Conference, Ss. Cyril and MethodiusUniversity in Skopje, Faculty of Physical Education, Sport, and Health,* 2018, pp. 23-27

3. V. Vuksanovikj, A. Acevski, J. Jovanovski, M. Majeric, I. Klincarov, G. Nikovski, **A.Saiti**, ISOKINETIC PEAK TORQUE VS 1RM TESTS AS RELIABLE METHOD TOFOLLOW UP POWER DEVELOPMENT, *3rd International Scientific Conference, Ss. Cyriland Methodius University in Skopje, Faculty of Physical Education, Sport, and Health,* 2018

4. **A. Saiti**, ASIMMETRY OF ANTHROPOMETRIC DIMENSIONS AND MOTOREFFICIENCY OF TABLE TENNIS PLAYERS IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA

WHO COMPETE IN THE SUPER LEAGUE AND FIRST LEAGUE, *First InternationalScientific Conference,Ss. Cyril and Methodius University in Skopje, Faculty of Physical Education, Sport, and Health,,*2014

5. V. Vuksanovikj, J. Jovanovski, **A. Saiti**, COMPARISON OF CHANGES IN THE MUSCULAR POWER POTENTIAL OF ELBOW FLEXORS AFTER A SIX-WEEK EXPERIMENTAL PROCEDURE WITH TWO GROUPS OF SUBJECTS WORKING ACCORDING TO THE STANDARD LOAD METHOD AND THE GREATEST SUCULE LOAD METHOD, *First International Scientific Conference,Ss. Cyril and MethodiusUniversity in Skopje, Faculty of Physical Education, Sport, and Health,,*2014

6. B. Saiti, **A. Saiti**, FACTOR STRUCTURE OF THE FOURTH-GRADE FEMALE STUDENTS IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA, *9th International Balkan Educationand Science Congrees,Trakya University Faculty of Education, Edrene-Turkey,* 2014.

7. B. Toçi, E.Karamelo (Zisi), **A.Saiti**, THE INFLUENCE OF TRAINING FOR CHILDREN WHITH SPECIAL NEEDS DURING A SCHOOL YEAR, *The 2nd International Conference, University of Shkodra "Luigj Gurakuqi" Faculty of Education Science, Fakulty of Social Science,* 2014

Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar komisioni recensues e konstatoi veprimtarinë shkencore-hulumtuese në periudhën paraprake, e cila është me rëndësi thelbësore për vlerësimin e kandidatit

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin "Nënë Tereza" Shkup, kandidati Dr. Sc. Agon Saiti ka realizuar gjithsej **30** pikë nga veprimtaria kërkimore-shkencore.

## IV. VEPRIMTARIA NGA INTERESI MË I GJËRË

1. Anëtar dhe refer kryesorë në garat nga Ping-pongu, të organizuar për të punësuarit e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi"Shkup.

2. Anëtar i komisionit për regjistrimet e studentëve të ri.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin "Nënë Tereza", kandidati Dr. Sc. Agon Saiti ka realizuar gjithsej **2** pikë nga veprimtaria me interes më të gjerë.

## V. VEPRIMTARIA SPORTIVE

- Instruktor skijimi i studentëve në Fakultetin e Kulturës Fizike (UT)
- Anëtar i jurisë së garave për skijim.
- Trajner-lojtarë i klubit të Ping pongut Vardar.
- Trajner-lojtarë i klubit të ping pongut Floraskop
- Nga viti 2017 është Drejtor sportiv në Federtën e ping-pongut të Maqedonisë
- Anëtar i bordit organizativ për Kampionatin Balkanit në ping pong për të rinj, Shkup 12-16 Qershor.
- Anëtar i bordit organizativ për turneun me karakter botëror për të rinj të ashtuquajtur ”ITTF World Junior Circuit”, Shkup 8-12 Tetor.
- 2005–Sportist i vitit në konkurrencën e sportistëve të qytetit te Shkupit (pingpong), Federatat e sporteve te Shkupit
- 2006 – Mirënjohje për pingpongist më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve për vitin 2005, Federata e pingpongut të Maqedonisë
- 2005 - Mirënjohje për pingpongist më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve për vitin 2004, Federata e pingpongut të Maqedonisë
- 2004- Shpërblimi “13 Nëntori ” për të arritura të larta në pingpong në Maqedoni, Këshilli drejtues i fondit për shpërblime “13 Nëntori”
- 2004- Mirënjohje për pingpongist më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve për vitin 2003, Federata e pingpongut të Maqedonisë
- 2003- Mirënjohje për pingpongist më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve për vitin 2002, Federata e pingpongut të Maqedonisë
- 2002- Mirënjohje për pingpongist më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve për vitin 2001, Federata e pingpongut të Maqedonisë
- 2001- Mirënjohje për pingpongist më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve për vitin 2000, Federata e pingpongut të Maqedonisë
- 1993-Shpërblimi “Fair Play” shpërblim i veçantë për sjellje sportive dhe korrekte gjatë lojës, Federata e pingpongut te Maqedonisë

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin “Nënë Tereza“, kandidati Dr. Sc. Agon Saiti ka realizuar gjithsej **57** pikë nga veprimtaritë sportive.

**SH T O J C Ë**

**PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE-RIZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE**

**Kandidati:** Agon Ismet Saiti
(emri, emri i prindit dhe mbiemri)

**Institucioni:** Sh.M.Q.Sh.” Zef Lush Marku”- Shkup
Universiteti Nënë Tereza, Fakulteti i Shkencave Sociale, drejtimi Sport dhe Shkenca Sportive
(emri i fakulteti/institucionit)
**Lëmi shkencor:** Kineziologji aplikative

## I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

| Nr. rendo | Emri i aktivitetit: | Pikët |
|---|---|---|
| I.1 | **I.1 Mbajtja e ligjëratave** (lëndët në ciklin e parë të studimeve) | **2.46** |
| | Ping-pong (2+2) semesti i III (2002-2003) | 4×15×1×0.04=**2,46** |
| | | |
| | **I.2 Mbajtja e ushtrimeve** (lëndët në ciklin e parë të studimeve) | **9** |
| | Antropomotorika (2+2), semestri I (2017-2018) | 4×15×1×0.03=**1,8** |
| | Bazat e kineziologjisë (2+2) sem II (2017-2018) | 4×15×1×0.03=**1,8** |
| I.2 | Bazat e statistikës në sport (2+2) semestri III (2018-2019) | 4×15×1×0.03=**1,8** |
| | Psikomotorika II (2+2) semestri i III-IV (1999-2002) | 4×15×2×0.03=**3,6** |
| | | |
| | **Konsultime me studentë** | **1.6** |
| | Antropomotorika (2+2), semestri I (2017-2018) | 40×4×1x0.002=**0,32** |
| | Bazat e statistikës në sport (2+2) semestri i III (2018-2019) | 40×4×1x0.002=**0,32** |
| | Ping-pong (2+2) semestri i III (2002-2003) | 40×4×1x0.002=**0.32** |
| I.3 | Psikomotorika II (2+2) semestri i III-IV (1999-2002) | 40×4×2x0002=**0,64** |
| | | |
| | **Gjithsej(I.1–I.4):** | **13.06 pikë** |

## II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

| Nr. | Emri i aktivitetit | Pikët |
|---|---|---|
| II.1 | **Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë profesionale/shkencore** | 24 |
| | A. Saiti, STRUCTURE OF ANTHROPOMETRIC DIMENSIONS OF TABLE TENNIS PLAYERS IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA WHO COMPETE IN THE SUPER LEAGUE AND FIRST LEAGUE, *3rd International Scientific Conference,Ss. Cyril and Methodius University in Skopje, Faculty of Physical Education, Sport, and Health,* 2018, pp. 17-21 | 4 |
| | A. Saiti, STRUCTURE OF BIOMOTOR ABILITIES OF TABLE TENNIS PLAYERS IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA WHO COMPETE IN THE SUPER LEAGUE AND FIRST LEAGUE, *3rd International Scientific Conference, Ss. Cyril and Methodius University in Skopje, Faculty of Physical Education, Sport, and Health,* 2018, pp. 23-27 | 4 |
| | V. Vuksanovikj, A. Acevski, J. Jovanovski, M. Majeric, I. Klincarov, G. Nikovski, A. Saiti, ISOKINETIC PEAK TORQUE VS 1RM TESTS AS RELIABLE METHOD TO FOLLOW UP POWER DEVELOPMENT, *3rd International Scientific Conference, Ss. Cyril and Methodius University in Skopje, Faculty of Physical Education, Sport, and Health,* 2018 | 4 |
| | A. Saiti, ASIMMETRY OF ANTHROPOMETRIC DIMENSIONS AND MOTOR EFFICIENCY OF TABLE TENNIS PLAYERS IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA WHO COMPETE IN THE SUPER LEAGUE AND FIRST LEAGUE, *First International Scientific Conference,Ss. Cyril and Methodius University in Skopje, Faculty of Physical Education, Sport, and Health,,*2014 | 4 |
| | V. Vuksanovikj, J. Jovanovski, A. Saiti, COMPARISON OF CHANGES IN THE MUSCULAR POWER | |

| | | |
|---|---|---|
| | POTENTIAL OF ELBOW FLEXORS AFTER A SIX-WEEK EXPERIMENTAL PROCEDURE WITH TWO GROUPS OF SUBJECTS WORKING ACCORDING TO THE STANDARD LOAD METHOD AND THE GREATEST SUCULE LOAD METHOD, *First International Scientific Conference,Ss. Cyril and Methodius University in Skopje, Faculty of Physical Education, Sport, and Health, ,*2014 | 4 |
| | B. Toçi, E.Karamelo (Zisi), A.Saiti, THE INFLUENCE OF TRAINING FOR CHILDREN WHITH SPECIAL NEEDS DURING A SCHOOL YEAR, *The 2nd International Conference, University of Shkodra "Luigj Gurakuqi" Faculty of Education Science, Fakulty of Social Science,* 2014 | 4 |
| **II.2** | **Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë profesionale/shkencore me bord redaktues ndërkombëtar** | 6 |
| | B. Saiti, A. Saiti, FACTOR STRUCTURE OF THE FOURTH-GRADE FEMALE STUDENTS IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA, *9th International Balkan Education and Science Congrees,Trakya University Faculty of Education, Edrene-Turkey,* 2014. | 6 |
| | **GJITHSEJ (II1-II2)** | **30** |

## III. VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË

| Nr. rendor | Emri i aktivitetit: | Pikët |
|---|---|---|
| **III.1** | 1. Anëtar dhe refer kryesorë në garat nga Ping-pongu, të organizuar për të punësuarit e Universitetit ”Shën Kirili dhe Metodi”Shkup. | 1 |
| **III.2** | 2. Anëtar i komisionit për regjistrimet e studentëve të ri. | 1 |
| **III** | **Gjithsej (III-1 dhe III-2)** | **2** |

## IV. VEPRIMTARIA SPORTIVE

| Nr.rendorë | Emri i aktivitetit: | |
|---|---|---|
| | - Instruktor skijimi i studentëve në Fakultetin e Kulturës Fizike (UT) | **1** |
| | - Anëtar i jurisë së garave për skijim. | **1** |
| | - Trajner-lojtarë i klubit të Ping pongut Vardar. | **1** |
| | - Trajner-lojtarë i klubit të ping pongut Floraskop | **1** |
| | - Nga viti 2017 është Drejtor sportiv në Federtën e ping-pongut të Maqedonisë | **2** |
| | - Anëtar i bordit organizativ për Kampionatin Balkanit në ping pong për të rinjë, Shkup 12-16 Qershor. | **3** |
| | -Anëtar i bordit organizativ për turneun me karakter botëror për të rinjë të ashtuquajtur ”ITTF World Junior Circuit”, Shkup 8-12 Tetor. | **3** |
| | - 2005 – Sportist i vitit në konkurrencën e sportistëve të qytetit te Shkupit (pingpong), Federatat e sporteve te | **5** |

| | | |
|---|---|---|
| | Shkupit | |
| **IV** | - 2006 – Mirënjohje për pingpongist më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve për vitin 2005, Federata e pingpongut të Maqedonisë | **5** |
| | - 2005 - Mirënjohje për pingpongist më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve për vitin 2004, Federata e pingpongut të Maqedonisë | **5** |
| | - 2004- Shpërblimi "13 Nëntori " për të arritura të larta në pingpong në Maqedoni, Këshilli drejtues i fondit për shpërblime "13 Nëntori" | **5** |

| | | |
|---|---|---|
| | - 2004- Mirënjohje për pingpongist më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve për vitin 2003, Federata e pingpongut të Maqedonisë | **5** |
| | - 2003- Mirënjohje për pingpongist më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve për vitin 2002, Federata e pingpongut të Maqedonisë | **5** |
| | - 2002- Mirënjohje për pingpongist më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve për vitin 2001, Federata e pingpongut të Maqedonisë | **5** |
| | - 2001- Mirënjohje për pingpongist më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve për vitin 2000, Federata e pingpongut të Maqedonisë | **5** |
| | - 1993 - Shpërblimi "Fer Plej" shpërblim i veçantë për sjellje sportive dhe korrekte gjatë lojës, Federata e pingpongut te Maqedonisë | **5** |
| **IV** | **Gjithsej** | **57** |

## V. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcë e bashkangjesim formularin për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore shkencore. Kandidatja **Dr. Sc. Agon Saiti** ka gjithsej **108.32** pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore **19.32** pikë, veprimtarinë shkencore –hulumtuese **30** pikë, veprimtaritë me interes të gjerë **2** pikë dhe veprimtaritë sportive **57** pikë.

| REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE | Pikët |
|---|---|
| VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE | 13.0 |
| VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE | 30 |
| VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË | 2 |
| VEPRIMTARIA SPORTIVE | 57 |
| Gjithsej | 102.06 |

## PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë të aktiviteteve në veprimtaritë mësimore arsimore, shkencore - hulumtuese, profesionale – aplikative, veprimtarive me interes më të gjerë, dhe veprimtaritë sportive, Komisioni konstaton se kandidati **Dr. Sc. Agon Saiti** në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin ”Nënë Tereza”, ka tubuar gjithsej **102.06** pikë, që duhet të realizohen për zgjedhjen në thirrjen mësimore–shkencore **Docent.**

Duke pasur parasysh atë që u paraqit më lartë, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit të shkencave sociale pranë Universitetit ”Nënë Tereza” në Shkup, që kandidati **Dr. Sc. Agon Saiti** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **DOCENT** në Fakultetin e Shkencave Sociale në lëmin e Kineziologjisë aplikative.

## KOMISIONI RECENSUES

1. **Prof. inor.dr. Blerim Saiti , kryetar d.v.**

   ______________________________

2. **Prof. Dr, Fadil Nika, anëtar d.v.**

   ______________________________

3. **Prof. Dr. Jovan Jovanovski, anëtar d.v.**

   ______________________________